

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyraren ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit S.Q. nga P., për shkak të veprës penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.999/17, të datës 01.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit Fillestar me datën 05.04.2017, në prezencën Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe në prezencën e të akuzuarit mori, ndërsa me datën 06.04.2017, publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.Q., i biri i G. dhe nënës F., e gjinisë B., i lindur me ... në P., tani me vendbanim në rrugën “M.K.” numër ..., në P., me numër personal ..., i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i vetëpunësuar, ka të kryer shkollën e mesme, më parë i padënuar dhe nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 04.02.2017, rreth orës 21:00, në P., në rrugën “J.Z.”, i pandehuri ka shkuar tek dera e banesës së të dëmtuarës, e ka thirr emrin e saj “E.”, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, me ç’rast ka shkel Urdhrin Mbrojtës të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas Aktvendimit C.nr.2029/2016 të datës 13.09.2016, e i cili urdhër mbrojtës ka qenë në fuqi dhe zgjatë 6 muaj nga dita e lëshimit të tij, e sipas të cilit të pandehurit i është ndaluar të përdorë presion psikik ndaj palës së mbrojtur E.M., si dhe ta shqetësoj palën e mbrojtur në banesën apo shtëpinë e saj nga data 13.09.2016 deri me datë 13.03.2017,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Andaj gjykata konform nenit 4, 41, 43, 46, 73 të KPRK-së, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të KPPRK-së, të njëjtit i shqipton:

D Ë N I M M Ë G J O B Ë

Në shumën prej **dyqind (200) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguaj në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, e me se largu deri me datën 5 (pesë) të muajit vijues.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do t’i zëvendësohet me dënim burgimi **duke iu llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

E dëmtuara: E.M. nga P., me vendbanim në rrugën "J.Z." në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr.999/17, të datës 01.03.2017, kundër të pandehurit S.Q.nga P., për shkak të veprës penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP/II.nr.999/17, të datës 01.03.2017.

Pas deklarimit të të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i Shtetit Blerim Igrishta, dha mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe shtoi se pranimi është bërë konform dispozitave ligjore me konkretisht në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-së, që do të thotë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, mbështetët në faktet dhe provat që gjenden në aktakuzë, nëse aktakuza nuk përmban shkelje ligjore ose faktike, e po ashtu kërkoj nga gjykata që me rastin e caktimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese aktin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri ashtu siç edhe parashihet me nenin 75 paragrafi 1 pika 1.3 të KPRK-së.

I akuzuari pas pranimin të fajësisë me tutje deklaroj se: jam penduar për veprimin e bërë dhe nuk do ta përsërisë asnjëherë, veprimet e mia i kam bërë për shkak se kam qenë i dashuruar me E., në kemi bashkëjetuar rreth dy vite e gjysmë edhe pse kemi pas probleme prapë jemi bashkuar, mirëpo qëllimi im nuk ka qenë ta frikësoj apo ta shqetësoj, por kam pas për qëllim që të bisedoj me të që të ribashkohemi prapë, jam i vetëdijshëm që e kam shkel urdhrin mbrojtës mirëpo i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsëris asnjëherë, pasi që kjo lidhje me nuk ka kuptim, i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrethana ti këtë parasysh dhe të me shqiptoj një dënim sa me të lehtë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje, për të cilën

akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e shqiptimit të dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është penduar për veprën e shkaktuar, i ka premtuar gjykatës qe nuk do të përsërisë veprime të tilla në të ardhmen, si dhe i njëjti nuk ka renë ndesh asnjëherë me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti pasojën e veprës penale pasi qe tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 2 pika 2.6 të KPPK-së.

Gjykata konform nenin 463 paragrafi 3 të KPRK-së, palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoj në kontest të rregullt juridiko-civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1009/17, datë 06.04.2017

Sekretare Juridike,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë(15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.